

22 2015

STUDIME

ASHAK

KDU 81 (05)
82 (05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME

Revistë për studime filologjike

22

2015



PRISHTINË
2016

PËRMBAJTJA	5
STUDIME, ARTIKUJ	7
Bahri Beci, Paris: Probleme të metodës së studimit të dukurive dialektore të shqipes	7
Victor A. Friedman, Universiteti i Çikagos: WYSIWYG: Prirjet e ndërrimet morfosintaksore dhe sintaksore në gjuhën shqipe	25
Bardh Rugova, Prishtinë: Gjuha e barsoletave	33
Bethany J. Christiansen and Brian D. Joseph, The Ohio State University: The Limits of Context in semantic Shift: A Case Study from Albanian	55
Teuta Abrashi, Prishtina: Lexikalische und strukturelle Unterschiede als Indizien für Sprachentwicklungen und kulturelle Differenzierungen	63
Bardhyl Demiraj, LMU München: <i>Fé</i> dhe <i>të prëmt e fës</i> në Kanunin e Lekë Dukagjinit	79
Skënder Gashi, Vjenë: Një fjalë e greqishtes së mesme dhe një toponim nga sllavishtja e vjetër në leksikon e në toponiminë e Kosovës	111
Norbert Boretzky, Bochum: Der Wortschatz der Drenica	125
Kolec Topalli, Tiranë: Duke hulumtuar për një gjysmë shekulli nëpër faqet e revistës “Studime filologjike”	197
Rexhep Ismajli, Prishtinë: Botimet e “Mesharit” të Buzukut	205
Ali Aliu, Prishtinë: Atdhedashuria si metaforë fataliteti	229
Norbert Jokl: Gjuha shqipe	237
ZHVILLIMET E REJA NË LETËRSINË SHQIPTARE	273
Eqrem Basha, Prishtinë: Fjala e hapjes	275
Ali Aliu, Prishtinë: Disa veçori krijuese të brezit më të ri letrar	277
Floresha Dado, Tiranë: Zhvillime në strukturën e brendshme të letërsisë pas nëntëdhjetës	281
Sabri Hamiti, Prishtinë: Letra	287
Dhurata Shehri Tiranë: “Banaliteti i të keqes”: Dhe etika e shkrimit në letërsinë e sotme shqipe	291
Kujtim Shala, Prishtinë: Dija e re letrare: Shkolla e Prishtinës	297
Fatmir Sulejmani, Tetovë: Histori e shkurtër e zhvillimeve të letërsisë shqipe në Maqedoni	309
Shaban Sinani: Tiranë: Letërsia e sotme në kornizën e së djeshmes	317
Ag Apolloni, Prishtinë: Probleme dhe perspektiva.	329

Nusret Krasniqi, Prishtinë: “Letërsia e re” dhe tradita letrare	335
Lindita Tahiri, Prishtinë: Libri i popullarizuar dhe letërsia autoritare	347
Agron Gashi, Prishtinë: Letërsia e re në shekullin e ri	355
Blerina Rogova Gaxha, Prishtinë: Etosi social në poezinë e sotme	365
Gëzim Aliu, Prishtinë: Poezia dhe proza e re në Kosovë	379
IN MEMORIAM	387
Bardhyl Demiraj, München: Hans-Jürgen Sasse (30. 04. 1943 – 14. 01. 2015)	387
Besim Kabashi, Erlangen: Punimet e Hans-Jürgen Sasse-s në fushën e arvanitistikës	391
KRITIKA, RECENSIONE	393
R. Ismajli, Prishtinë: Leonardo M. Savoia, (bashkë me M. Rita Manzini e Benedetta Baldi): <i>Studime në gjuhësinë shqiptare</i> , Prishtinë, AShAK, 2015, ff. 243,	393
M. Halimi, Prishtinë: Skënder Gashi: <i>Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës</i> , Prishtinë, 2015, ff. 783.	399
B. Rugova, Prishtinë: Rexhep Ismajli: <i>Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik</i> , AShAK, Prishtinë, 2015, ff. 546.	405
Sh. Elezi-M. Vokri, Prishtinë: <i>Studimet albanistike në Amerikë</i> . Për- mbledhje punimesh të Konferencës shkencore, Redaktor R. Ismajli, Prishtinë, ASHAK, 2016, ff. 666,	409
INDEKSAT	413

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München

FÉ DHE TË PRÉMT E FÉS NË KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT

KDU 811.18-112

*“In principio erat Verbum
et
Verbum erat apud Deum
et
Deus erat Verbum.”
(Johannes 1.1)*

1. Hyrje: Àt Gjeçovi dhe receptimi i veprës së tij në kohën tonë

Në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip njehim sot për sot me gishtat e njëres dorë pinjollë të tillë që të kenë lënë gjurmë e hedhur rrënjë jo thjesht dhe vetëm me prurjet e tyre masive, por edhe – madje sidomos – me metodikën hullindjekëse të punës qoftë në mbledhjen dhe grumbullimin e materialit kulturor-gjuhësor në terren, ashtu edhe në sistematizimin, klasifikimin dhe përgatitjen e tij për një botim të atillë që gëzon gjithherë si miratimin dhe respektin e një rrethi të gjerë lexuesish, ashtu edhe mirakandjen e studiuesve të fushës për të ecur e për t’u thelluar në atë hulli. Ndër ta mund të kumtojmë pa rrudhje vetullash emrin e Àt Shtjefën Konstandin Gjeçovit O.F.M. dora vetë, i mirënjohur në kulturën e shkrimit shqip sidomos për ngulmin e tij me fiksuar në shkrim Kodin Zakonor ase “Doketar” (Fishta 1933) në ato vise malore të Shqipërisë së Veriut, ku Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD) gëzonte dikur rolin e të vetmit rregullator në marrëdhëniet sociale, ekonomike dhe kulturore brendapërbrenda bashkësisë shqiptare. Gjithsesi u desh të birrej mot, shumë mot – deri në kapërcyell të shekullit të shkuar – kur mjedisi intelektual në Shqipëri të mund të përcillte së fundi në tregun e librit shqip e më gjerë, përpos ribotimit të “Kanunit të Lekë Dukagjinit. Përmbledhë e kodifikue prej Àt Shtjefen

Konst. Gjeçov O.F.M.”⁶⁰, një numër gjithnjë në rritje të varianteve të Kodit Zakonor Shqiptar, që vepronte mirëfilli dikur e – në masë të konsiderueshme – edhe sot e kësaj dite në treva të tëra etnografike të malësisë shqiptare, të tilla si Labëria, “Arbënia” (= Kanuni i Skanderbegut me veprim në zonën e Kurbinit, Krujës dhe Tiranës), Luma, Dibra; madje nuk mungojnë as variante të vetë Kanunit të Lekës me përhapje deri diku më të kufizuar krahinore, të tilla si varianti i Pukës apo ai i Mirditës etj.⁶¹ Padyshim që realizimin e gjithë kësaj ndërmarrjeje ballore në kohën tonë vështirë të mos e përcjellim si njohje, nxitje, frymëzim dhe studim të thelluar të asaj nisme fanmirë të At Gjeçovit, që vjen me thënë të atij mesazhi sa shkencor-metodik aq edhe atdhetar që kumton sot e gjithë ditën angazhimi social dhe vepra e tij madhore në jetën dhe kulturën shqiptare.

Parë nga perspektiva e albanologjisë si shkencë gjuhësore-filologjike, në këtë larmi variantesh të Kodit Zakonor Shqiptar – kushtëzuar sigurisht si prej kohës së fiksimit të tyre në shkrim, ashtu edhe prej zonës etnografike ku vepronte njëri apo tjetri syresh – gjëllin një thesar i vyer gjuhësor, i mbledhur drejtpërsëdrejti prej traditës gojore, krehja e të cilit të lejon, ndër të tjera, shqyrtime dhe përsiatje me karakter të mirëfilltë etnolinguistik, pra mundëson nergut rindërtimin e historisë së brendshme që kanë përjetuar e përjetojnë sot njësi të tilla leksikore me përdorim leksikor specifik (vetëm?) në diskursin popullor të jetës zakonore shqiptare.

2.1. Objekti i studimit: *fe,-ja* dhe spektri i saj semantik në leksikografinë shqipe

Hyjmë kështu natyrshëm në temën tonë të studimit, duke marrë në analizë një njësi leksikore me përdorim deri diku “të pazakonshëm”, sa i përket shfaqjes dhe përdorimit të saj në fjalësin doketar të Kanunit të Lekës. (shih §

⁶⁰ Shkodër 1933¹; (Botime Françeskane) 2002³. Ndër botimet në gjuhë të huaj dallojmë a) italisht: Dodaj 1941¹, Martucci (bot.) 2013²; b) gjermanisht: Godin 1953¹, Elsie (bot.) 2001²; c) anglisht: Fox 1989; d) frengjisht: Gut 2001.

⁶¹ Shih ndër të tjerë: a) Kanuni i Skanderbegut/“Arbënisë”: Imz. Ilija 1993; b) Kanuni i Labërisë: Elezi 1994; c) Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varianti i Pukës): Meçi 1997; d) Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varianti i Mirditës): Meçi 2002; e) Kanuni i Dibrës, Marini 2007; f) Kanuni i Lumës: Hoxha 2013 etc.

2.2) Bëjmë fjalë këtu bash për njësinë leksikore *fe, -ja* (f., shm. *fe, -të*), sa të përçudnuar aq edhe të nëpërkëmbur dikur – madje edhe në leksikografinë zyrtare të shtetit të parë dhe të fundit ateist në botë (FGJSSH 1980 459⁶²) –, aq sa që nuk ka mundur ende të rimarrë veten sa e siç duhet sot e gjithë ditën qoftë edhe në botimet më të fundit leksikografike me pretendim shkencor-akademik. Mjafton të përmendim këtu vetëm njërin syresh, shi botimin e ripunuar të fjalorit akademik të gjuhës shqipe (FGJSH 2006 265), ku shpjegimi i këtij zëri ngërthen gjithë-gjithë një rresht të një kolone:

“**fe, -ja** f. sh. **-(të)**: besimi te Zoti a te një perëndi.”

Një përbërës të dytë semantik të kësaj fjale arrijmë gjithsesi ta qëmtojmë vetëm në fjalorin e parë zyrtar të shqipes (FGS 1954 115), ku ky zë regjistrohët padyshim si i tillë, veçse me dy kuptime kryesore:

“**fe-ja** ef., shm. – : 1. idé dhe pikëpamje të bazuara në mistikë, në besimin se ekzistojnë forca dhe qenie që bëjnë mrekullira: *-ja është opiumi i popullit* (Marksi); 2. nishani i martesës.”

Ishte pikërisht përbërësi i dytë semantik, i regjistruar në këtë fjalor, ai që na joshi të mihnim thellë e më thellë në leksikografinë historike të gjuhës shqipe, ku vend kryesor zë padyshim vepra monumentale e E. Çabejt “Studime etimologjike në fushë të shqipes” I-VII (Tiranë 1976-2014). Në bleun IV (1996 153v.) Çabej na kumton, përpos kuptimit kryesor “besim fetar” dhe burimit të saj prej lat. (kisht.) *fides* “besimi i krishterë” (< lat. klas. *fidēs* “besim; besë, besnikëri [...]”), se *fe* ka edhe kuptimin “fejesë; gostë e fejesës; nishan i fejesës”, duke cituar në këtë rast me akribinë e vet marramendëse:

“... *fe* ka edhe kuptimin “fejesë; gostë e fejesës; nishan i fejesës”; VK XI 126v.; FGS “2. Nishan i martesës”. VK XI [= Nikollë Gazulli: Fjaluer i Ri. Tiranë 1941 – B.D.]⁶³ f. 126v. [...] *Pres fenë* është “fejoj” (vajzën); *kam da*

⁶² “**FE, ~JA** f. sh. ~, ~**TË**: Besimi i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyreshme, hyjnore, i cili ka lindur në kohë shumë të hershme dhe është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; tërësi dogmash që japin një botëkuptim fund e krye idealist e reaksionar, i cili është armik i betuar i përparimit e i shkencës, dhe përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; besimi te zoti. *Feja e krishterë* (ortodokse, katolike, myslimane). *Origjina (përhapja) e fesë. Lufta kundër fesë. Ndërroi fenë. Mohoj (luftoj) fenë. Feja është opium për popullin.*”

⁶³ Sqarimi ynë, i vendosur në kllapa katrore do vështruar më fort si homazh ndaj mënyrës së citimit të Çabejt: model i saktësisë së tij të zakonshme shkencore e sidomos

dit, kam premun fe “kam shënuar ditën (e marrjes së nuses)”. Në të folët e Pukës “dasëm vajze”. Te kanuni i Lekës (f. 11 § 30/ç, f. 14 §44) *Djali sa të ket prind s'ka tager as në shej, as në petka, as në këpucë, e as në të prëm fejet; Me pre fën do me thanë me da ditën a vaden e kputme se kur me nisë krushqt për me marrë nusen*. Në Iballë *po shkoj m fe çike* (Xh. Topalli DS II 327), në Dukagjin *kam qit çikën, po eni në fe.*”

Sa i përket përdorimit dhe fiksimit të nuancave kuptimore të fjalës në ardhën e fjalorëve dhe glosarëve të mëhershëm një- a dygjuhësh (me fjalë të rra-lla të shqipes) në shek. XIX dhe XX, nuk mund të lemë assesë pa vënë në dukje ndërkaq, sidomos shpjegimin e kësaj fjale prej Àt Benedikt Demës O.F.M. në veprën e tij postume (2005 57), ku na kumton, sa vijon:

“**fe,-ja**: 1) virtyt neper të cilin u besohet të vertetave të zbulueme prej Zotit e asht një ndër tri virtytet teologale; 2) besim, religjon; 3) fejesë, vëlesë; 4) gosta qi bahet për fejesë.”

Duke cituar së fundi dhe Fjalorin e Bashkimit (1909 107) me kuptimin e dytë të regjistruar në të: “(it.) maniera” – krahas “credenza religiosa” – shpresojmë të kemi përmyllur kështu gjithë atë spektër kuptimor të përdorimit të kësaj fjale në hapësirën kompakte shqipfolëse, duke u përqendruar këtu sidomos në shqipen e Veriut e në materialin gjuhësor mbledhur prej Àt Gjeçovit⁶⁴.

Prashtu një vështrim më i hollësishëm i trashëgimisë leksikografike që disponojmë na lejon tash të izolojmë pa vështirësi gjallesën e një tufëze kuptimesh të kësaj fjale me përdorim (mbarë)dialektor, ndër të tjera: 1) “besim fetar, religjon”: si emërtim apo shënjes specifik në terminologjinë (popullore) fetare, i përhapur sot gjithkund në hapësirën shqipfolëse në Ballkan. Në këtë përdorim *fe* konkurren sot bindshëm – sidomos në Veri të arealit shqipfolës – në ligjërimin e përditshëm dhe në gjuhën e shkruar apelativët popullore: (shq.) *besë* e *besim* si edhe (turq.) *iman*; ndërkohë që kuptimi 2) “njëri ndër tri virtytet hyjnore/teologale”: *Feja* kundrejt *Shpresës* dhe të *Dashurit* (= it. *fede* ~ *speranza* ~ *carità*), si përbërës vetëm i terminologjisë kristiane na

mishërim i rreptësisë së tij “tënëzare” po aq të zakonshme, sa herë që bëhej fjalë atëbotë për të cituar prurjet e martirëve të përçudnuar, albanologë të rangut të Dom Nikollë Gazullit, Àt Benedikt Demës etj.

⁶⁴ Shih Bashkimi (Shkodër 1909 107): “Fee,-ia, vf. shum. fee-t: maa mire se; fëna-t. Fede, credenza religiosa, maniera.”; Cordignano (1934 35): “fë,-ja; -na,-t (f.) fede, religione; specie, sorta, indole; Es.: *S’e due fën e tí. S’ká fë të tí* = a suo modo non è possibile.”

shfaqet rregullisht bash në ato vise etnografike të Shqipërisë (Veriore) ku është përhapur sidomos besimi i krishterë katolik-romak⁶⁵. Me këtë kuptim lidhet pandërmjetshëm edhe kuptimi pas gjase dytësor 3) “mënyrë, sjellje” (Bashkimi 1909 107), i kufizuar në përdorim në trevat e Shqipërisë së Veriut. Sa i përket kuptimeve të tjera leksikore të fjalës, të regjistruara deri sot: 4) “fejesë”: *pres fenë* “fejoj (vajzën)” (Çabej *loc. cit.*); 5) “gosta që zhvillohet për fejesë” (Gazulli FR 1941 127); 6) “dasmë vajze” (Dema 2005 57), vërejmë se ato gjëllijnë gjithashtu në trevat e Veriut të Shqipërisë, që vjen me thënë, se përdorimi i fjalës në këto kuptime të ashtuquajtura “shtesë” përjeton rrudhje, sa i përket përhapjes së saj dialektore vetëm në ato treva.

2.2. Qëllimi i studimit: qerthulli problemor me diskutimin përkatës

Këto vëzhgime paraprake na nxisin dashur-pa-dashur të hedhim hapat e parë në gjurmimin e historisë, thënë më saktë, të jetës së brendshme që ka përjetuar kjo fjalë në gjuhën shqipe në kohë dhe hapësirë. Duke përshkuar këtë hulli synojmë në radhë të parë me përsiatur – e pse jo?! – me vërtetuar një bashkëlidhje të mundshme zanafillëse ndërmjet përbërësve kuptimorë themelorë që ngërthen spektri semantik i kësaj fjale të parme në diskursin zakonor shqiptar, meqë për burimin e saj etimologjik si huazim latin – siç do ta shohim më poshtë (§ 5) – deri sot vetëm tek-tuk janë hedhur gremçat e dyshimit. Për më tepër, këta përbërës janë ngulitur ndërkohë fort në çerdhen leksikore të fjalës, duke mbuluar si të tilla dy fusha thelbësore në matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar:

A. “besimi (fetar)”: shq. *fe*, (geg.) *fë* f. “besim fetar (i krishterë katolik / ortodoks ose mysliman etj.); virtyt hyjnor; mënyrë sjelljeje⁶⁶” ⇒ khs. *fetar*, *i pafe* (~ geg. vj. *i fëshim*, *i pāfē*), mb.; *fetari*, -a f.; *fetarisht* ndf.; etj. (FGJSH 2006 267) dhe

B. “tradita e jetës zakonore shqiptare”: shq. **fë*: (dial. geg. ver.) *fë* f. “fejesë; dita/gosta e f.; dasmë vajze” ⇒ *fejoj* (vajzën, djalin) fol.⁶⁷ ⇒ *fejesë* f.; *i/e fejuar*

⁶⁵ Shih Çabej *loc. cit.*

⁶⁶ Shih shën. 5.

⁶⁷ Sipas Çabejt (SE IV 155v.) në zanafillë “një fjalë dialektore (e gegërishtes), përgjithësuar në gjuhë.”, khs.: Buzuku (XIV Luka 1, 27) *feonj*; tosk. jug. (Labëri, Gjirokastër) *fijoj*.

mb./m. (FGJSH 2006 265).

A lejohemi të bashkëlidhim tash në këndvështrimin etnolinguistik këta dy përbërës semantikë themelorë në spektrin polisemik të fjalës (sikurse edhe në çerdhen leksikore përkatëse), përkatësisht të diktojmë se në ç' masë mund të kenë ndikuar ata në kohë e hapësirë ndaj njëri-tjetrit? Siç cekëm më lart, për të zhdrivilluar këtë dysi pyetjesh, vështirë se na ndihmon sa duhet e siç duhet përsiatja pas gjase e patëmetë e burimit zanafillës latin (kishtar/mesjetar?) të fjalës shqipe, sikurse edhe rrethana tashmë e mirënjohur që ndikimi latino-roman mbi shqipen ka vijuar shekuj të tërë e në vazhdimësi, duke i hapur më pas udhë atij italo-venecian përgjatë gjithë mesjetës dhe kohës së re e deri sot në ditët tona. Sigurisht që në këtë rast nuk ndihmon aspak polisemia e konsiderueshme e gje gjëses it. *fede*, krahas dalm./veliot. *faid*, që janë po ashtu rrjedhoja të drejtpërdrejta të lat. (kisht.) *fides*⁶⁸.

Asgjëmangut, në bashkëvajtje me këtë komb pyetjesh mund të shtrojmë ndërkaq edhe një të fundit, shi nëse gjëllin(te) diku a dikur në shqipe edhe ndonjë përbërës “i tretë” semantik, ase një i tillë qoftë edhe bashkëpërfshirës e burimor, që të ketë nxitur motmoti zhvillime semantike të ashtuquajtura “të mëvonshme”, të cilat mund e duhet të ketë përjetuar kjo fjalë në shqipe në kohë e hapësirë? Është pikërisht kjo pyetje e fundit që i shtojmë përsiatjeve tona, fillimisht në formë hipoteze, lidhur me shqyrtimin etnolinguistik të lemës *fe* si zë i veçantë leksikor edhe në veprën madhore të Çabejt, ku – siç cituam më lart – Philologus Albaniae mëngon të përcjellë shembuj e pasazhe edhe prej thesarit kulturor-gjuhësor të Kanunit të Lekës, të mbledhur dhe klasifikuar me aq përkushtim prej At Gjeçovit.

3. “Të prëmt e fës” dhe gje gjëset e saj në Kodin Zakonor Shqiptar

Një shfletim sado i përciptë, por në tërësi, i tekstit të At Gjeçovit na lejon tash të vijmë natyrshëm në përfundimin se *fe* – qoftë edhe si shënjues specifik në terminologjinë (popullore) kishtarë – na shfaqet në KLD me një denduri relativisht të rrallë, e këtë e tumir thjesht fakti se kemi të bëjmë aty më fort me

Shih edhe Kristoforidhi (1903) 101: *fe* (me shënimin: shih *besë*), 103: (Shkodër) *fëjoj*, *fijoj* etj.

⁶⁸ Shih Meyer-Lübke (REW 3285 285): lat. *fides* “besë; besim”.

një tekst normativ-taksativ që rregullon marrëdhëniet sociale-ekonomike dhe kulturore-praktike brendapërbrenda bashkësisë, duke ngërthyer në to sidomos masat ndëshkimore që ndërmerren bashkësisë si e tillë ndaj shkeljeve flagrante të Kodit Zakonor Shqiptar, të sendërtuar në rastin tonë në KLD. Gjithsesi, nuk është vështirë të izolohet në tekst me pak a shumë siguri përdorimin e saj në secilën fushë (semantike) të matriksit të kulturës etnike shqiptare që parashtruan më lart.

A. “Besimi fetar”: *fe* “besimi i krishterë (katolik-romak)” mëton në rastin tonë në pamje të parë një rol dytësor e na shfaqet, siç pritet, kryesisht në *Liber i parë* që i kushtohet *Kishës* si institucion administrativ-kishtar dhe i ushtrimit të kultit fetar në zonën etnografike të Dukagjinit, duke përcaktuar qartë, se *Kisha*, *Pronet e Kishës* dhe vetë *famullitari* i nënshtrohen vetëm *Ligjës* ase *Kanunit të Kishës*, d.m.th. të Drejtës Kanonike Kishtare, për të cilin ka tagër mbikqyrës dhe vendimmarrës vetëm *i Pari i Fés* (= ipeshkvi), madje edhe në ato raste kur famullitari kryen akte ose veprime më se të ndëshkueshme prej vetë *Kanunit të Lekës*; khs.⁶⁹:

“Lib. I: Kisha; Art. i parë: Pjesa qytetnore (f. 1vv.)

Kr. I, Nye i parë: Hija e Kishës

§ 3 Papërlimsia e Kishës “Kisha nuk giobitet.”, “Kisha s’ka peng me kend.”

1. Kisha gjindet e vendosne nen sundim të *të Parit të Fés* e jo nen ligjë të Kanunit: prandej Kanuni s’mund t’i vëjë kurrnji barrë kishës, veç se ká detyrë me i dalë zot, kúr kjo hupë ndihmen e tij.

2. Me bëjtë ndonji kundërshtim ndermjet kishës e famullís, famullija s’mund t’i lypë pëng kishës; veç do të bëjë váj te *i Pari i Fés* - te Ipeshkvi - e gjygit të këtij, si kisha si famullija, do t’i rríjn pá fjalë. [...]

Kr. I, Nye i katërt: Meshtari i Famullís, ase famullitari (f. 3v.)

§ 9: Tagri e detyrët e Famullitarit

4. Famullitari [...] perposë *të Parit të vet* [...]

5. Famullitari ká detyrë me i bâ Famullís gjith at sherbim shpirtit e *Fejet*, qi atij i a vën barrë *Kanuni i Kishës*, e mâ teper edhe do sherbime tjera të posaçme nder do ditë të shënueme, si me thânë: me bekue shpijat, me thânë Meshë ndo’i herë në motmot nder vorre të largta prej kishës së Famullís etj. [...]

Kr. 7: Amtyra e ndeshkimeve (f. 5v.)

⁶⁹ Dallimet në kursiv në këta shembuj si edhe në shembujt që vijojnë janë bërë prej nesh.

§ 14 Vetëm Bajraktari me krenë, e ndo'i herë edhe me të Parë të Kishës, ka tager me ia caktue ndeshkimin fajit të bâm kundra kishës.”

Brenda paletës së kësaj fushe semantike (A.) ndeshim edhe përdorimin specifik të fjalës deri në funksionin e së Drejtës Kanonike Kishtare, sikurse e dëshmojnë paragrafët përkatës në KLD mbi llojet e martesës, përkatësisht përshtatja e tyre sipas rregullave kanonike të dhurimit ase ndalimit të Sakramentit të Martesës prej famullitarit dora vetë; khs.:

“Libër i tretë: Martesa

Nye 11: Percaktimi e mëndyrët e Martesës

§ 28: Percaktimi i Martesës në *Kanû* [...]

§ 29: Mëndyrët e Martesës

- a) Martesa me kunorë, e pelqyeme kah *Feja e kanuja e Lekës*;
- b) Grueja e mbajtme mbí kunorë, kundra *Fejet e kanujet të Lekës*;
- c) Grueja e vajza e grabitme, e jasht-zakonshme kahë *Feja e kanuja*;
- ç) Martesa me provë kundra *Fejet e kanujet*. [...]

Kr. V: Kanuni i dhandrris. (f. 35vv.)

Nye 32: Grueja e pá-kunorë (f. 41vv.)

Aj, qi të mârre gruen e pá kunorë, jet i lidhun kah *Feja* edhe kah *kanuja*.

B. “Tradita e jetës zakonore shqiptare”: *fe* *“fejesë; dita/gosta e fejesës; dasmë vajze” (shih lart § 2.1.) – Me këtë përdorim specifik të regjistruar në leksikografinë shqiptare fjalën nuk e hasim në asnjë rast konkret në KLD, ndërkohë që këto kuptime mbulohen gjithkund në tekst me formime të prejardhura brenda çerdhes leksikore përkatëse (shih lart § 2.2.), khs.: *fe* ⇒ geg. *me fejuë* fol. ⇒ *fejesë* f., *i/e fejuem/e* mb.; sikurse edhe në bashkëvajtje me njësi të tjera brenda së njëjtës fushë leksikore, si p.sh.: *dasmë/gostë* (e *fejesës*) etj.⁷⁰ Gjithashtu, nuk mund të lemë në heshtje, përkundrazi duhet t’i mëshojmë fort faktit që kjo fjalë na shfaqet në materialin e mbledhur prej Àt Gjeçovit – në gjithë-gjithë katër raste – edhe si term popullor me përdorim specifik po brenda kësaj fushe, veçse me tjetër funksion, duke u shfaqur gjithherë në togje të ngulitura: a) foljore: “*me pre fën*”; dhe b) emërore: “*fë e preme*”, “*të prëm fejet*”⁷¹; khs.:

⁷⁰ Shembuj të shumtë p.sh. në Liber III: Martesa, Krye III: Shkuesija, Fejesa; Nye 16.: Fejesa etj. (Gjeçov KLD 1933 12vv.)

⁷¹ Duke përdorur thonjëzat respektojmë në këtë rast regjistrimin e markuar prej vetë Gjeçovit, i cili izolon në këtë mënyrë materialin e mirëfilltë gjuhësor-kulturor të mbledhur në terren, prej atyre ndërhyrjeve përkatësisht atij sistematizimi vetjak të materialit me shpjegimet përkatëse që mbajnë firmën dhe autorësinë e tij në tekst.

[a] KLD: (?) Varianti i Dukagjinit (Gjeçov 1933)]

“Liber i tretë: Martesa (f. 10vv.)

Nye XII: Tagri i djalit e i vajzës

§ 30: Tagri i djalit: “Djali ka tager me mendue per martesë të vet, po s’pat prind. ...

Djali sá të ket prind s’ká tager: c) m’u perzie në fejesë të vet; ç) as në shêj, as në petka, as në këpucë e as në *të prëm fejet*. [...]

Nye XVIII: E premja e Fës. Dita më shêj (f. 14)

§ 44. Percaktimi i “*Fës së preme*.”

“*Me pré Fén*” do’ me thënë me dá ditën e vaden e kputme se kúr me nisë krushqt per me mârre nusen.

Si t’i “*pritet feja*” vajzës, tuj kënë ditë më shêj, krushqt do të nisen at ditë pá tjera fjalë, e ket ditë as kanuja s’e shtÿn, as bân qi të shtÿhet.

Krushqt do të shkojn me mârre nusen at ditë, edhë me dijtë se â’ tuj deké nusja, zhargas e rrshânas do t’a çojn në shpí të dhandrrit.

Krushqve s’u ndalet udha, edhë me pasë të dekmin në shpí, prindja e dhandrrit a prindja e vajzës.

I dekni në shpí, krushqt do të nisen; nusja hinë në shpí, i dekni del shpijet.

Andej të vajtohet, këndej të këndohet. (Kjo thohet per me diftue se as deka ket ditë s’mund t’i ndalë krushqt, se me këndue nuk këndohet.)”

Një përqsasje ballafaqe me variante të ndryshme – ndërkohë të regjistruara – të Kodit Zakonor Shqiptar qoftë në krahina të tjera etnografike si p.sh. Mati, Luma, “Arbënia”, ashtu edhe me dy variante brendapërbrenda hapësirës së veprimit të KLD, bash në Pukë dhe Mirditë, na lejon tash të vendosim gurët e sinorit për atë areal-dialektor ku na shfaqet ky kuptim specifik i fjalës në togjet e ngulitura: *me pré fenë, e premja e fës, të premt e fës* (= <é> = [e:] = /ē/) kundrejt gjegjëseve përkatëse: *me dá/pré ditën; përkatësisht e damja/ premja e ditës; khs*⁷²:

b) KLD: Varianti i Pukës (Meçi 1997)

2. Lidhjet rituale të familjes

Kreu II: Dasma [f. 58vv.]

§ 104: *Dita e dame*

⁷² Duke qenë gjithkund i mirëqenë në mbarë arealin shqipfolës, përdorimin e fjalës në fushën semantike A: “Besimi (fetar – katolik/ ortodoks, musliman)” e kemi lënë më vetëdije jashtë çdo lloj përqsajeje.

Nuse e dazëm nuk ka pa la ana e djalit të prumet e të shtumet. U lanë krejt me të madhe e me të vogël, ana e djalit ka të drejtë me lyp *ditën e dame*, me lyp *fenë*. *Fenë e ditën e dame* e cakton ana e çikës. Me caktue ka të drejtë, po me kërkue jo. E kërkoi, lshon të binë në marre, “Çika kërkon burrë”. E kërkon, kur don me e ba anën e djalit me hek dorë me doemos: “O merre, o lshoe. E xamja ka cak.”

§ 105: E bamja gati dhe e thirrma në dazëm

Me u ba gati për dazëm, fillohet *me t'u da dita e fesë*.

I zoti shpisë ka detyrë [...]

§ 106: *E thirrma në fe* dhe detyrat e të thirrurve

Në *fe* thirren miq e shokë ma pak se në *dazëm*. Me thirr çohen thirrcit dy javë para. Të shkuemit në *fe* kanë detyrë me prit e me qit miqtë simbas zakonit. Shkojnë 2-3 orë para krushqve e largohen 2-3 orë mbas tyne. Bijat vinë ditën që xihet çika. [...]

Kreu III: Krushq e nuse në *fe* e në *dazëm* [f. 59v.]

§ 111: *Përgatitja e nuses* [...]

Vërejtje: Përdorimi i fjalës sonë në këtë variant të KLD tumir nga njëra anë materialin gjuhësor e leksikografik të kësaj zone, të cituar së pari prej Çabejt (SE IV 153v.), ku *fe* (f.) rezulton si “ceremonia zakonore e dorëzimit të nuses” krahas “gostë/ dasmë vajze” në dallim nga *dazëm* (f.) “dasmë djali (si ceremoni zakonore e martesës)” e nga ana tjetër përdorimin e fjalës në materialin kanunor të mbledhur prej Àt Gjeçovit (shih më lart), ku *fe* pa kurrfarë dyshimi ka të bëjë me *ditën e dame*, d.m.th. me ditën e fiksuar me marrëveshje nga të dyja palët e krushqisë për të marrë vajzën e (fejuar e të) nisur dhe stolisur nuse⁷³. Me interes në hetimin e historisë së brendshme të fjalës është në

⁷³ Në përkthimet që ka përjetuar teksti i Àt Gjeçovit vërejmë në shumicën disa raste shmangie nga kuptimi i mirëfilltë i fjalës në këtë përdorim, khs.: 1) italisht (Dodaj 1941): § 30 *stabilire la data del matrimonio* [= me vendosë ditën e martesës – B.D.]; § 44: “*Fissare la data*” – *Giorno straordinario*; [= fiksoj ditën – dita në shêj – B.D.]; 2) gjermanisht (Godin te Elsie 2001²): § 30 *die Ablegung des Versprechens* [= dhënia e premtimit – B.D.]; § 44 *Die Bindung der Treue*. – Der Tag des Zeichens [= Lidhja e besës – Dita në shêj – B.D.]; 3) anglisht (Fox 1989): § 30: the setting of the marriage date [= vendos ditën e martesës – B.D.]; § 44: “*Cutting the Betrothal*” – the Marked Day [= prerje e fejesës – Dita në shêj – B.D.]; frëngjisht (Gut 2001): § 30 “la fixation du mariage”, § 44 “la date fixée”.

këtë rast sidomos mbajtja parasysh e togjeve foljore në tekst: *me lyp fenë = me da ditën e fesë* “me kërkuar/ fiksuar ditën e marrjes së vajzës-nuse” etj.

c) KLD: varianti i Mirditës (Meçi 2002)

Kreu XII: Përgatitja e dasmës (f. 54vv.)

§ 66: *Me pre ditë.*

Si të ketë mërqirin shpija djalit, lyp *me* i *pre ditë*, ditën e dasmës.

Tagrin e ka shpija e djalit. Me e caktue e cakton i zoti i shpisë së cucës.

Kreu XIII: Krushqit (f. 56v.)

§ 72 Nisja e krushve - “*Dita e preme s’njeh mot as mort*”

Dita e preme ashtë ditë në shej. Kanuja çat ditë njeh. Edhe me dekë kush në shpi të djalit ja të cucës, *dita e preme* nuk ndalet as nuk ndrrohet. [...]

Krusht marrin udhë me agun e ditës [...]

Vërejtje: Në këtë variant të KLD nuk ndeshim në asnjë rast në tekst përdorimin e *fe*-së me kuptimin në shqyrtim, edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtin autor teksti me atë të variantit të Pukës (: Xhemal Meçi). Gjithsesi nuk është vështirë të vendosim shenjën e barazisë të përdorimit sinonimik ndërmjet togjeve të ngulitura *me pré fën, fë e preme* (KLD: Dukagjin – Gjeçov 1933) dhe *me pre ditë, dita e preme* (KLD: Mirditë – Meçi 2002), ndërsa varianti i Pukës (KLD: Pukë – Meçi 1997), me përzierje alternative të të dyja mundësive, na ndërmjetëson një zonë kalimtare. Një situatë të njëjtë gjuhësore me variantin mirditor të KLD dëshmojnë edhe zonat të tjera etnografike të malësisë shqiptare, të paktën aty ku është mbledhur, sistemuar dhe klasifikuar materiali gjuhësor i Kodit Zakonor Shqiptar, khs.:

d) Kanuni i Skanderbegut/”Arbënisë” (Ilia 1993)

Kr. IV: Fejesa e martesë

Art. IV: E drejta e djalit për fejesë e martesë të vet

§ 156 Djali pa prind [...] shumë punë i ban me anën e t’afërmve të vet, si: me çue shejin, *me da ditën e darsmës* etj.

Art. XIV: *Dita e ndame* për darsëm

§ 251 *Dita e ndame* për darsëm nuk luhet për asnji arsye [...]

§ 258 Mbasi të jetë nda *dita e martesës* [...]

e) Kanuni i Dibrës (Martini 2007, 243vv.)

§ 1181: Shpia e djalit i kërkon shpisë së vashës së fejueme kohën kur bahet dasma. Kjo kërkesë quhet “*e lipmja e nuses*”.

[...]

§ 1190: Mueji e *data e dasmës* caktohen kur “*të ndahet dita*”.

§ 1191: *Dita e dasmës*, po u caktue, nuk mund të afrohet e as nuk mund të largohet. Me qanë kaderr, *dasm’* e mort bahen në një ditë. [...]

f) Kodi Zakonor: Kanuni i Lumës (Hoxha 2013)

II. Lidhjet rituale. Ritet kryesore (f. 131vv.)

Kr. III: Darsma. Përgatitjet (f. 134vv.)

§ 313 [...] 3.- *Damja e ditës së darsmës* f. 135v.

“Si të dahet dita e darsmës nuk luhet ma.”

“*Ditën e darsmës e dan shpia e cucës jo e djalit.*”

§ 314-318: [...] *Dita e darsmës* dahet 1-5 javë përpara. Për me *da ditën e darsmës* shkohet në ditë të ejte a të diel (Arrën)

Kr. V: Krushqit e përcjellsit (f. 144vv.)

Kr. VI: *Darsma* në shtëpinë e cucës (f. 146v.)

Darsma e cucës asht gjithmonë e vogël [...]

g) Kanuni i Labërisë/Papazhulit

Të njëjtën situatë gjuhësore me pikat c), d), e), f) e ndeshim edhe në Kanunin ende “të pakodifikuar” në trevat malore të Labërisë. Kumtin e parë na e jep për këto treva Godin në pasazhet e përkthimit gjermanisht të KLD, ku për shprehjen: “*Me pré Féñ*” shpejton të shtojë shënimin: “Shprehja në kanunin e Papazhulit është: “den Tag schneiden“ [= pres/ ndaj ditën – B.D.].⁷⁴

Vëzhgime paraprake

Kjo paraqitje e thukët e situatës gjuhësore në Kodin Zakonor Shqiptar, të mbledhur dhe sistematizuar ndërkohë për disa zona etnografike të arealit kulturor shqipfolës, na lejon tash të vendosim përfundimisht shenjën e barazimit midis përdorimit specifik të kësaj fjale në KLD në togjet e ngulitura: *me prē*

⁷⁴ Shih Elsie 2001 66: “Der Ausdruck im *Kanun i Papazhulit* ist: “Den Tag schneiden.”. Për hollësi në “marrëdhëniet martesore sipas të drejtës zakonore familjare të Labërisë” shih Elezi 1994 74vv.

fën, fë e preme, të prëm fejet (pas gjase vetëm në trevat gjuhësore-etnografike të Dukagjinit e të Pukës) me gjithkund gjetkë: *me (n)dā ditën, dīt e (n)dame/ e preme* (~ tosk. *ndaj/ pres ditën e dasmës*). Asgjëmangut, në të dyja situatat gjuhësore bëhet fjalë pikërisht për fiksimin me marrëveshje të ditës, kur ka për të ardhur shpura e krushqve të dhëndrit me marrë vajzën – të nisur e stolisur nuse – prej shtëpisë së saj prindërore e me e përcjellë atë në shtëpinë e dhëndrit, ku zhvillohet ceremonia e dasmës së mirëfilltë si pikë kulmore e gjithë asaj procedure, që nga njëra anë përmbyll fazën e fejesës si lidhje e vajzës “nën unazë”⁷⁵ e nga ana tjetër i hap udhë *dasmës* si akt kanunor i martesës së çiftit.⁷⁶

Falë kësaj parashtrese bëhet tash më se e qartë edhe bashkëlidhja semantike me përdorimin pas gjase dytësor të *fë* si “dasmë/gostë vajze”, d.m.th. si akt zakonor festiv bash ditën e përcjelljes së vajzës-nuse prej shtëpisë prindërore, duke i hapur kështu udhë festës së dasmës në shtëpi të dhëndrit (shën. 17), khs.: “*Darsma* e cucës asht gjithmonë e vogël” (Kanuni i Lumës – Hoxha 2013 146); “... në Dukagjin *kam qit çikën, po eni në fe*” (Çabej, *loc. cit.*); “Krushq e nuse në *fe* e në *dazëm*” (KLD: varianti i Pukës – Meçi 1997 59v.)

3. “*Të prëmt e fës*” si dukuri kulturore në jetën zakonore shqiptare

Po të vijojmë të ecim tani në këtë hulli që u hap vetiu e natyrshëm, mund t’i përcjellim lexuesit po aq vetiu e natyrshëm përsiatjen tonë lidhur me do kuptime të tjera të regjistruara të fjalës që rezultojnë si zhvillime paralele në rrethana të ngjashme kulturore-gjuhësore. Kështu, kërshërinë tonë fillestare ndaj saktësisë së rreptë të Çabejt (§ 2.1.; shën. 4) e shton tani edhe më shumë kumti i tij: “*Pres fenë* është “fejoj” (vajzën)”, një dëshmi gjuhësore kjo që përkon çuditshëm vetëm formalisht me togun e ngulitur që cituam më lart në tekstin e KLD me autor At Gjeçovin (1933 § 44), por me tjetër kuptim: ““*Me pré Fén*” do’ me thënë me dá ditën e vaden e kputme se kúr me nisë krushqt per me mârre nusen.”

A kemi të bëjmë këtu me një bashkëpërkim të rastësishëm gjuhësor, ase me një përdorim të paqenë e të shënuar ashtu nxitimthi e pa kujdes për njësinë *fe* te njëri apo tjetri leksikograf shqiptar, apo lejohemi të përsiasim një kuptim

⁷⁵ Shih më hollësisht Gjeçov (1933 13: “Vajza nen unazë); Ilia (1993 29v.: “Sheji”; 31v.: “[...] nen unazë”); Meçi (2002 53: “Cuca nën unazë”) etj.

⁷⁶ Khs. Ilia (1993 33v.: “Darsma”): § 268 “Darsma në kanu asht marrja e nuses dhe qitja nuse e vajzës, me krushq darsmor, miq e shokë dhe gosta qe u shtrohet atyne.”

më përfshirës, në të cilin *fe* – më vete ose edhe në togje të ngulitura si: *pres fenë* – sendërton në gjuhë konceptin e “fjalës së dhënë”, d.m.th. të *fjalës së (n)dame* apo të *k(ë)putme*, e cila në traditën e jetës zakonore shqiptare gëzon statusin e dorëzanisë së lidhur gojarisht e që sendërtohet me pika kulmore në dy ditë të fiksuara me “fjalën e dhënë” ndërmjet palëve të krushqisë: a) dita e shpalljes së fejesës, dhe b) dita e marrjes në dorëzim të vajzës-nuse në prag të dasmës “së madhe”, d.m.th. festimit të aktit zakonor të martesës në shtëpi të dhëndrrit? (shën. 17).

Sa i përket pyetjes së parë, mjafton të marrim në analizë, ndër të tjera, çerdhen leksikore të fjalës, e cila e tumir katërcipërisht ngulmin e Çabejt (*loc. cit.*), sipas të cilit “*Pres fenë* është edhe “fejoj” (vajzën)” (shih. § 4). Andaj le t’i përmbahemi fillimisht pamjes kulturore-historike të kësaj dukurie, duke u përqendruar fillimisht në dy pikat kulmore, si dy marrëveshje paraprake me *fjalëdhënie* midis palëve të krushqisë. Në këtë rast do shtuar këtu se e para: shpallja e fejesës, është e lidhur pazgjidhshmërisht me dorëzimin e (geg.) *shë-jit* (/ (tosk.) *nishanit*) nga krushqia e dhëndrit: “Shëji, mje ke të hjekish dorë, t’ a bân nierin t’ andin”, shkruan At Gjeçovi (1993 13: Nye 17), duke mos harruar si gjithmonë thonjëzat, pra gurrën burimore e të thukët të kanunit;⁷⁷ ndërsa e dyta: “Dita më shëj” apo “E premja e fës” (Gjeçov 1933, § 44 14) parakupton shlyerjen e të gjitha detyrimeve materiale nga pala e krushqisë së dhëndrit. Të gjitha fazat që përjeton periudha (deri njëvjeçare) e *fejesës* = “unazës” në normën zakonore të Veriut (KLD) na i sqaron saktësisht Meçi (1997 45vv.) për KLD në variantin e Pukës, sa vijon:

Kreu XI: Shkuesia dhe fejesa.

§ 44 Nusja xehet me shkuesi. Shkues caktohet burrë e jo grue [...]

§ 47: E xanmja e çikës, *fjala e kputme*.

Çika *quhet e xanme* kur shkuesi merr *fjalën e kputme*: “Ta paçim fal.”

§ 48: Sheji i të xanmes së çikës.

⁷⁷ Shih edhe Ilia (1993 29 [Art. X]): “§ 202 I zoti i shtëpisë vajzës, porsa merr shejin në dorë thotë: “Na kjoftë për hajr miqësia.” I ati i dhandrrit përgjigjet: “Zoti mos na e ndaftë miqësinë.” E shkuesi uron: “Ju kjoftë për hajr miqësia”. § 203. Kur i zoti i shtëpisë së vajzës thotë: “Na kjoftë për hajr miqësia.”, “vajza asht e xanun.”. Shprehja *zë nuse* për “fejoj” ka qenë dhe është tipike edhe në Jug të Shqipërisë.

Çika *bahet e xanme*, kur çohet *sheji*. Shejin e çon i zoti i shpisë me shkuesin përpara. Sheji asht: rizë e unazë e një qese pare [...]

§ 49: *Të prumet* për veshën e nuses

Natën e shejit, si lehet rizë e unazë, miku lyp me i pre edhe *të prumet* e cakun e të lames së tyne. [...] Të prumet janë gjashtë qese. Herët ishin tre qese [pare: grosh/korona – B.D.].

§ 50: *Të shtumet* për veshë e të fala.

Ana e çikës mbas *të prumeve* mund të kërkojë edhe *të shtuemet* [...] *nji deri dy palë tesha nusesh* [...]

Kreu II: Dasma [f. 58vv.]

§ 104: *Dita e dame*

Nuse e dazëm nuk ka pa la ana e djalit *të prumet* e *të shtumet*. U lanë krejt me të madhe e me të vogël, ana e djalit ka të drejtë me lyp *ditën e dame*, me lyp *fenë*. *Fenë e ditën e dame* e cakton ana e çikës. Me caktue ka të drejtë, po me kërkuje jo. E kërkoj, lshon të binë në marre, “Çika kërkon burrë”. E kërkon, kur don me e ba anën e djalit me hek dorë me doemos: “O merre, o lshoe. E xamja ka cak.”

Pasazhin e mësipërm lejohemi kështu ta përcjellim bindshëm si ilustrim të gjithë asaj procedure të institucionalizuar në jetën zakonore (të malësisë) shqiptare, që e përcjell *fejesën* (= dial. geg. *fën* ~ *fenë*) si një fenomen etno-kulturor, i cili ngërthen përpos a) marrëveshjes për *fejesë* si premtim, d.m.th. si *fjalë e dhënë* (= *fjala e kputme/dame/preme*), edhe b) kumtin publik: shpalljen e saj në bashkësi si të mirëqenë falë dorëzimit të *shëjit/nishanit* (= unazë e fejesës, rizë/shami, mërqiri etj.); më tej c) fazën përgatitore për martesë: përgatitja e *pajës* (= sipas rastit me *të prumet*, *të shtumet* e *të falat* e palës së dhëndrit) e duke u përmbyllur c) me ditën e marrjes së nuses (= *dita e dame/kputme/preme* = dial. geg. *feja*).

Sigurisht që e gjithë kjo procedurë, përkatësisht kjo fazë përgatitore para aktit zakonor të martesës parakupton(te) në shtresa të ndryshme të bashkësisë etnike shqiptare me karakter të theksuar patriarkal jo aq një gjakim apo sendërtim marrëdhëniesh emocionale⁷⁸ ndërmjet dy të fejuarve, se sa një lidhje

⁷⁸ Në Kodin Zakonor Shqiptar, sikurse gjithkund në doracakët ligjorë, edhe syresh shtetërorë, është vështirë që lexuesi të ndeshë ndonjë pasazh, ku flitet ose mbahen

apo forcim aleancash juridike-zakonore ndërmjet shtëpive, fiseve ose grupimeve farefisnore, të përfaqësuara në rastin konkret me dy të rinj tashmë të fejuar, të cilët – thënë me lezet (!) – e njihnin fare pak e jo rrallë aspak për së gjalli njëri-tjetrin. Parë nga perspektiva e Kodit Zakonor Shqiptar kjo fazë përgatitore e fejesës mund të gjykohet pra thjesht dhe vetëm si provë reciproke ose forcim i aleancës (së ardhshme) ndërmjet dy shtëpive, fiseve apo grupimeve farefisnore që i mirëbesojnë me dorëzani njëri-tjetrit, duke prerë, ndarë ose këputur fjalën me njëri-tjetrin a) së pari për zënien e vajzës “nën unazë” dhe b) së fundi për dorëzimin e saj në shtëpinë e dhëndrit, me motivin: “m’ u bâ shpí, me ia shtue shpís një rob mâ teper, sá per krah të pûnve, sá per te shtuem të fmive” (Gjeçov KLD 10).

4. Spektri semantik dhe radiusi areal-dialektor zanafillës i *fe*-së në gjuhën shqipe

Mungesa e shënjesit specifik *fe* në Kodin Zakonor Shqiptar në bashkëlidhje me atë përdorim semantik që përsiatëm më lart: **“fjalë e prerë/ ndarë/ këputur”* (për *me çue shêjin* = me shpallur fejesën) – qoftë kjo fjalë në përdorim më vete: *fe*, ose në togje të ngulitura, të tilla si: *pres/lyp fenë* ose *ditën e fesë* – na lejon tash t’i kthehemi rishtas tekstit hullindjekës të KLD të mbledhur prej At Gjeçovit, duke përsiatur me dashamirësi, se mos ndoshta ai vetë është treguar paksa “i kujdesshëm” me tekstin e rrjedhshëm, që vjen me thënë – e pse jo! – i ndërgjegjshëm për të mos krijuar konfuzion te lexuesi sqimatar, e për rrjedhojë të ketë mënjeluar me vetëdije këso rasash përdorimin e *fe*-së në tekst, qoftë edhe për shkak të ngarkesës së lartë polisemike që bart kjo fjalë në KLD sikurse gjithkund në arealin kulturor të Veriut.

Asgjëmangut, përsiatjen tonë që *fe* të ketë gjëllirë dikur në ligjërimin shqip edhe me këtë përdorim ndërkohë (pas gjase) të rrëgjuar, e mbështet qartë dhe bindshëm prania e çerdhes leksikore e fjalës edhe në KLD, ku feksin formimet me prejardhje në fushën kuptimore: B. “Tradita e jetës zakonore shqiptare”: *fe* **“fjalë e dhënë/këputur”* = *fjala e kputme* (KLD: varianti i Pukës – Meçi 1997) ⇒ *fejoj* (vajzën) fol. “*pres fenë*, këpus fjalën për të fejuar

parasysh intimitete, përkatësisht marrëdhënie emocionale ndërmjet të dy të rinjve të fejuar (me mblesëri).

(vajzën)” (< {fe-} + {-o-} + {mbaresë}); khs. *punë* f. ⇒ *pun-o-j* fol.) ⇒ *fejesë* f. (< {fej/o-} + {-esë}); khs. *kërkoj* fol. ⇒ *kërkesë* f.).

Që kjo fjalë me këtë kuptim erdhi e bori në rrjedhë të kohës gjithnjë e më shumë terren në gjuhën e folur, duke përjetuar vise-vise një lloj ngurtësimi që priret sot drejt rrëgjimit të plotë, do parë kjo rrethanë pas gjase si një rrjedhë e natyrshme e një dukurie gjuhësore që u kushtëzua që në fillim prej rolit të humbësit në një konkurrencë pas gjase binare: Kështu, vërejmë a) së pari brenda spektrit semantik të fjalës një distancim largvajtës deri në shkëputje të plotë të marrëdhënieve semantike zanafillëse ndaj kuptimeve ndërkohë kryesore: “besim fetar; virtyt hyjnor”; dhe b) së dyti brenda çerdhes leksikore përkatëse në përplasje ballafaqë me formimin e ri prejfoljor, pas gjase më shprehës: (*fejo-j* ⇒ *fejesë, fëjesë*, (tosk. jug.) *fjjesë*⁷⁹).

Duke ecur në këtë hulli, kundrojmë si çështje të fundit, që lidhet ngushtë me historinë e brendshme që ka përjetuar kjo fjalë në gjuhën shqipe, moshën dhe përhapjen e *fe*-së në zanafillë në hapësirën kompakte shqipfolëse e diasporën historike shqiptare. Si pikënisje në këto shtjellime na duhet të konsultojmë rishtas për t’u orientuar sa dhe si duhet vetë kumtin e Çabejt. Kështu, ndërsa për çerdhen leksikore të fjalës, sidomos për foljen *fejoj* së bashku me rrjedhojat e saj, ai këmbëngul me akribinë e tij të zakonshme, se kemi të bëjmë me një “fjalë dialektore (të gegërishtes) e përgjithësuar në gjuhë” (SE IV 156), për lemën *fe* bashkë me spektrin e saj semantik edhe në shkrimet e tij – sado rrallë e për mall (!) – rëndon ora e heshtjes. Andaj sekush lejohet të përcjellë paraprakisht në debat mëdyshjen, se mos ndoshta edhe *fe* si fjalë e parme nuk do të ketë qenë vërtet e përhapur dikur gjithkund në gjuhë; përndryshe do të duhet të pranojmë edhe në këtë rast një farë rrudhjeje largvajtëse të radiusit të saj zanafillës në arealin kulturor të Veriut (katolik) shqiptar, përkatësisht në veri të hapësirës kompakte shqipfolëse.

Vështirësitë për të kërkuar e gjetur argumente pozitive deri diku të pranueshme me mëtuar të kundërtën i shton realiteti gjuhësor-historik si në kul-

⁷⁹ Shih për hollësi më lart shën. 8. Gjithashtu vërejmë se në kumtin e tij për *fejoj* si “Fjalë dialektore (e gegërishtes) e përgjithësuar në gjuhë” Çabej (SE IV 156v.) ecën pas gjase në gjurmët e Kristoforidhit (1903 101), i cili edhe format *fëjoj* e *fjjoj* i izolon si variante të mbledhura (vetëm) në Shkodër, ndërsa ndërtimin prejfoljor *fejesë* nuk e regjistron fare si zë leksikor.

turën e shkrimit shqip sikurse edhe indikatorët e përhapjes dialektore të fjalës në kohë e hapësirë. E ky realitet gjuhësor-historik na përcjell në fakt thuajse vetëm argumente negative, sa i përket përdorimit të fjalës në zanafillë edhe në Jug të hapësirës shqipfolëse, ku gjithkund e te gjithkush në shekujt e parë të kulturës së shkrimit shqip hasim natyrshëm vetëm gjegjësen anase *besë* f. edhe me kuptimet “fe, besim fetar”. Është pikërisht ky emër që e ndeshnim të vetëm deri vonë në toskërishte, madje edhe sot e kësaj dite në diasporën arvanitase në Greqi sikurse edhe në atë arbëreshe në Italinë e Jugut/ Sicili. Kështu *besë*-n e qëmtojmë qysh në përmendoren e parë të shkrimit shqip në këtë dialekt (Matranga 1592⁸⁰) e në vazhdimësi në shekujt e mëvonshëm (Shek. XVIII: Kostë Berati; Anonimi i Elbasanit; Kavalioti⁸¹ etj.). Përkundrazi dëshmia e parë që kemi mundur të izolojmë gjatë krehjes së materialit gjuhësor në dialektin toskë për gjegjësen *fe* në kuptimin “besim fetar”, datohet jo më larg se shek. XVIII, madje në Divanin e Nezim Frakullës (dsh. i Sami Frashërit⁸²), ku *fe* dhe *besë* na shfaqen nga një herë të vetme e në rrethana thuajse identike tekstore-gjuhësore, khs.:

[...] Mynafiku që s'mban fenë, [...] Mynafiku është një qen,
dërgoje prej teje qenë, as e një besë nuk' e gjen,
u-tërboft' e martë dhenë [...] more shpirt zalim u ben [...]

Rrethana kulturore-historike që na përcjell kjo dëshmi e parë gjuhësore e fjalës sonë në dialektin toskë, d.m.th. përdorimi i saj në rrethe kulturore-fetare shqiptare me theks të fuqishëm oriental-fetar (mysliman) nuk mund të mos mbahet parasysh në hetimin e kronologjisë së fjalës në Jug të hapësirës kompakte shqipfolëse, ndër të tjera edhe për të shtyrë gjallesën e saj në një periudhë të mëparshme kohore.

Rrethana më pak bindëse lidhur me përdorimin e dikurshëm të fjalës *fe* si “besim fetar” në diasporën arbëreshe na ofron lematizimi i saj si edhe ai i një numri përbërësish të çerdhes leksikore përkatëse në: “Leksiko liti kthiellë ar-

⁸⁰ Khs.: Matranga (dsh. 1 10v: virtutet): /quattro cioè fede speranza charità et buone opere = katër: besë, pandohi të dashurë e të bk:me të mira/.

⁸¹ Khs.: Kostë Berati: /[...] pamë dritënë e vërtetë | e muarmë frymë; nga qiellja gjetmë besë | të vërtetë/ (f. 211); Anonimi i Elbasanit (1761): /[...] mos u ban i pabesë | po me besë. u përgjeq Tho|mai e tha: o ZT im e perëndi|a im. tha atij Jisusi [...] / (19 1-4 – Gjoni 20: 27); Kavalioti (1770): /besë = πίστις/ (nr. 776)

⁸² Shih Abazi-Egro 2005.

bërisht” (1763 – dsh.⁸³) me autor eruditin arbëresh Nikollë Keta (= <Nicolò Chetta>): /fede, credenza = besa/, /fede di religione = feja; *senza fede* i pāfeu/ [...] /fedele di religione = i fëshimi/, /fedeltà = me besë, fëshim/. Regjistrimi i këtyre fjalëve është pas gjithë gjasash një përvojë e fituar prej tij gjatë leximit të autorëve të vjetër të Veriut si Bardhi e Bogdani⁸⁴.

Asgjëmangut, një gjykim sado pozitiv dhe optimist lidhur me praninë e njërës apo tjetrës dëshmi në truall të shqipes ose në diasporë, të çon vetiu e natyrshëm në përfundimin, sipas të cilit, edhe sikur *fe* (gjithsesi vetëm) në kuptimin “besim fetar” të ketë pasur në zanafillë një përdorim të gjithmbarshëm në gjuhë, ajo nuk do të ketë mundur të përballojë dot konkurrencën me gjegjësen anase *besë* në Jug të Shqipërisë, duke iu nënshtruar në vazhdimësi bjerrjes sidomos në Jug të hapësirës kompakte shqipfolëse. Bëjmë fjalë këtu në çdo rast për një rrëgjim relativisht të hershëm, d.m.th. shumë më të hershëm se fillesat e kulturës së shkrimit shqip – siç e njohim deri sot –, përderisa kjo fjalë nuk gjëllin si e tillë as në diasporën historike shqiptare në Greqi dhe Italinë e Jugut/ Sicili.

Përpos këtij faktori historik-gjuhësor do mbajtur parasysh këtu edhe faktori historik-kulturor, meqë mbase nuk është thjesht rastësi që shënjuesi konkurrent *besë* të ketë zënë rrënjë e hedhur shtat me kuptimin “fe, besim fetar” qoftë në kulturën ortodokse të shkrimit shqip (shih më lart) ashtu edhe në terminologjinë popullore fetare ortodokse, sikurse na e dëshmojnë sot e gjithë ditën të folmet e diasporës arvanitase dhe arbëreshe ku vepron e dirigjon Kisha Ortodokse, përkatësisht ajo Uniade (katolike) e ritit bizantin⁸⁵.

⁸³ Shih Cemiglia 2008 15.

⁸⁴ Në këtë përfundim erdhi shkruesi i këtyre radhëve pas këshillimit instruktiv me mikun dhe kolegun e tij Matteo Mandalà. Në këtë hulli të çon edhe shfaqja sporadike e fjalës në “Canti sacri” arbëreshe të botuara prej Giuseppe Schirò (1907; Mandalà (bot.) 1998), khs.: /[...] për të vërtetën fë, ngjera çë rruan = per la vera religione, finché vissero/ (bl. VI LXXXV rr. 2), që në bot. origjinal bukurtingëllon: /Për besën e vërtetë për sã rruan./ (Mandalà 1998 280). Regjistrimi i kësaj fjale në fjalorët e sotëm të arbërishtes jepet jo rrallë me referimin e botimit të Schirò-it, shih Giordano (1963; 2000² 107), Gerbino (2007 28) etj.

⁸⁵ Për fjalorin e Kupitorit: Jochalas 2006: ‘Υδρα II 725; Jochalas 2011 562; Figlia (dsh.-shek. XVIII) 1995 247; Chetta (dsh. 1763) 2008 116; Giordano (1963) 2000 29 etj.

5. Çështje të burimit dhe kronologjisë së huazimit të *fe*-së në gjuhën shqipe

Është pikërisht hetimi dheashak rindërtimi i këtij realiteti kulturor-gjuhësor që na lejon tash të rimarrim së fundi në vështrim çështje që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me etimonin dhe kronologjinë e huazimit të kësaj fjale në gjuhën shqipe. Sigurisht që edhe në këtë rast kemi dhe duhet të kemi si pikë orientimi kumtin e Çabejt, i cili si rrallëkush në historinë e albanologjisë ofron vjelje ballore në çështje të etimologjisë e të leksikut historik të shqipës deri në çastin kur iu shkëput përfundimisht penda nga dora. Kështu, në njërin ble postum të veprës së tij monumentale “Studime etimologjike në fushë të shqipës” (IV 153v.) Çabej na mëson se ndër studiuesit e deriatëhershëm feks sidomos emri i Gustav Meyer-it, babait të albanologjisë moderne, i cili mëton një burim të fjalës prej formës it. *fe* si shkurtrim poetik i it. *fede* gjithnjë me kuptimin “besim fetar, religjion”. Vetë Çabej i kundërvihet këtij mendimi me një argument gjuhësor sa të thjeshtë aq edhe bindës: tek autorët e vjetër të Veriut, sikurse edhe sot në Veri, kjo fjalë njërrrokëshe del me zanore të gjatë, e cila ruhet edhe në ndërtimet e pathjeshta, khs.: (Buzuku, Budi, Bardhi etj.) <fee> *fē*, <i paafee> i *pāfē*, <i feescim> i *fēshim* etj. Andaj Çabej i kthehet mendimit të burimit latin të fjalës prej lat. *fides* (kall. *fidem*), duke shtuar, se: “Me burimin latin pajton dhe zhdukja e mbylltoreve të zëshme në pozicion ndërzanor në fjalët e vjetra (trashëgime dhe huazime latine) të shqipës [...] e në pikëpamje historike rrethana që terminologjia kishtare e shqipës në pjesën më të madhe është e gurrës latine.”

Gurrës latine të fjalës shqipe (Miklosich AF II 26) i përmbahen pak a shumë edhe studiues të shumtë të kohës sonë⁸⁶, përpos Bonnet-së (1998 170), i cili vë rishtas në dyshim burimin latin të fjalës, duke sjellë si argumente: a) mungesën e fjalës në katekizmin e parë të njohur në gjuhën shqipe (Matranga 1592): “[...] duke titulluar katekizmin e tij *E mbsuame e krështerë* e jo **Feja e krështerë*, Matranga zgjodhi pa dyshim një fjalë që ngjasonte më pranë gjuhës së përditshme se sa *fe* ...”, si edhe b) “praninë e sinonimit anas *besë*”, duke vijuar që: “ne do të parapëlqenim këtu më fort gjurmën e ndikimit të një kleri të formuar në Itali, sidomos të françeskanëve të dërguar aty [= në Shqipëri –

⁸⁶ Shih së fundi Orel 1998 94: me të dhëna bibliografike shtesë.

B.D.] në mision gjatë mesjetës.”⁸⁷

Në pasazhin e mësipërm nuk është vështirë të qëmtohet një pakujdesi që i ka shpëtuar pa dashje Bonnet-së në përkthimin e titullit të katekizmit të Matrangës, i cili në rast zgjedhjeje alternative nuk do të përkonte aspak me **Feja e krështerë*, por me **Doktrina e krështerë*, sindëkur e ndeshim edhe tek autorët e vjetër të Veriut (Budi 1618: <Doctrine>; Kazazi 1743: <Doctrina e Kærsceten>). Se sa mund të ketë ndikuar ky keqkuptim në argumentin e dytë, që sjell autori kundër burimit latin të fjalës, këtë e kemi ndërkaq të vështirë me e zhdrivilluar sa e siç duhet, ndërkohë që vetë mungesa e argumentit gjuhësor në gjithë atë pasazh na nxit tash të kërkojmë e të gjejmë syresh që arrijnë të saktesojnë me siguri relative – domethënë gjuhësore (!) – vetë caqet kohore të huazimit.

Prashtu nuk mund të mos tumirim fillimisht argumentin gjuhësor të Çabejt, sipas të cilit bjerrja e një mbylltoreje ndërzanore */-d-/ (në trup të fjalës) është një dukuri e lashtë që ka rrokur kryesisht shtresën e fondit latin në gjuhën shqipe, e kjo, sipas nesh, ka ndodhur pas gjithë gjasash për shkaqe të natyrës fonotaktike, bash në një periudhë të zhvillimit të protoshqipes, kur ishte (bërë) i porealizueshëm nyjëtimi i mbylltores dhëmbore të zëshme */-d-/ në trup të fjalës, khs. *gjygj* (shq. vj. *gjyġj*) < lat. *iūdicium*; *mjek* < lat. *medicus*, *pyll* (shq. vj. *pyll*) < lat. *padūlem*; *va* (shq. vj. *vā*) < *vadum* etj.⁸⁸ Në të kundërtën, faktet gjuhësore nuk e pranojnë këtë dukuri në periudhën e ndikimit italian-venecian në shqipe, kur mbylltorja ndërzanore */-d-/ iu nënshtrua një procesi frikatizimi në */-ð-/ , khs. *adhuroj* < it. *adorare*; (+Buz.) *xhudhi* “jude, çifut” < it. vj. *giudio*; *tradhëtor*, *tradhëtu(a)r* m. < it. *traditore* etj. (Helbig 1903 109, 120, 134)

⁸⁷ Citati origjinal: “Quant à l’argument du registre de langue, on peut le retourner: en intitulant son catéchisme *E mbësua me e krështerë* et non **Feja e krështerë*, Matrënga choisit sans doute un mot qui lui semblait plus proche de la langue ordinaire que *fe* ... L’existence d’un synonyme indigène, *besë*, fait douter d’un emprunt au latin: nous y verrions plutôt ici la trace de l’influence d’un clergé formé en Italie, en particulier des franciscains envoyés là, durant le Moyen Age, en mission.”

⁸⁸ Demiraj 2003 171vv. Kjo dukuri – sipas shkruarit të këtyre radhëve – nuk e ka rrokur aspak leksikon e fondit autokton të shqipes, ku në këtë periudhë mbylltorja e zëshme */-d-/ ndërzanore i ishte nënshtruar me kohë procesit të frikatizimit në /-dh-/ = [ð]. Shih më hollësisht Demiraj 2001 57vv.

Meqë nuk vërejmë tani kurrfarë motivi gjuhësor me e vënë në dyshim burimin latin të fjalës sonë, nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të hetojmë si çështje të fundit në studimin tonë pikërisht periudhën e depërtimit të saj në gjuhën shqipe. Sigurisht që edhe në këtë pikë pikënisjen e kërkojmë dhe e gjejmë në kumtin e Çabejt, për të cilin lidhur me fjalën *fe* do mbajtur parasysh: “[...] në pikëpamje historike rrethana që terminologjia kishtarë e shqipes në pjesën më të madhe është e gurrës latine.” (SE IV 154). Në një punim të mëparshëm i jemi përkushtuar kësaj teme në këndvështrimin etnolinguistik, duke thelluar me argumente gjuhësore mendimin se kristianizimi i bashkësisë etnike-gjuhësore (proto)shqipe do parë e vështruar mirëfilli: a) si një proces kulturor-historik i përfunduar në periudhën midis shek. IV-VI; në çdo rast para dyndjeve të sllavëve në Ballkan, përkatësisht kontakteve të saja intensive me fiset sllavejugore, b) një proces ky që mori formë e hodhi shtat falë misionimit largvajtës e në vazhdimësi të Kishës Perëndimore (Romë/Vatikan) edhe në ato treva ku flitej e flitet sot shqip; e se ky ndikim i drejtpërdrejtë përjetoi tronditjet e para shi aty nga fillimet e shek. VIII (v. 726), kur perandori bizantin Leon III, ndaloi me rreptësi përdorimin e latinishtes si gjuhë zyrtare-administrative (sidomos në ushtri) e bashkë me të edhe primatin e Kishës Perëndimore në infrastrukturën kishtarë dhe objektet e kultit në të gjithë hapësirën ballkanike, duke ligjëruar për to krahasurvejimit edhe përkujdesjen shpirtërore nga ana e Kishës Lindore (Bizantine/ Kostandinopojës)⁸⁹.

A disponojmë dhe a mund ta shfrytëzojmë ndonjë argument gjuhësor, që lejon të syzojmë një depërtim të fjalës latine – në rastin tonë – mesjetare-kishtarë në shqipe bash në këtë periudhë të mesjetës së hershme: shek. IV/VI-VIII, që vjen me thënë në një fazë, kur të paktën në jug të hapësirës së sotme shqipfolëse ndikimi i Kishës Lindore (= Bizantine) po bëhej gjithnjë e më shumë i pranishëm në jetën kulturore-zakonore edhe të etnosit shqiptar?⁹⁰

⁸⁹ “Kjo fazë përkon pak a shumë në kohë me periudhën e mirënjohur në historinë bizantine si “Lufta e ikonave” (shek. VIII – IX), pikërisht kur perandori bizantin Leo III vulosi *de jure* juridiksionin e Kishës së Lindjes mbi gjithë Ballkanin (viti 726).” Demiraj 2001/2 29vv.; 2011 63v.

⁹⁰ Për ndikimin në rritje të Kishës Bizantine në shek. VIII në zonat e Jugut, përkatësisht për gjurmët gjuhësore të famshmes Luftë e Ikonave në periudhën e Perandorit bizantin Leon III, shih së fundi Demiraj 2001/2 29vv.; 34; 2011 63v.: khs. (shek. VII-VIII) dial. tosk. *korë* < gr. mes. (εἰ)κόνα “ikonë” krahas formës së vonë tosk./geg. (Budi) *ikonë*.

Hetimi në detaj i atij materiali gjuhësor, sado të pakët, që disponojmë – sikurse edhe përhapja dialektore-historike e fjalës në hapësirën e sotme kompakte shqipfolëse e në diasporë (shih më lart) – na lejon të mëtojmë një syzim të tillë pa rrudhur aspak vetullat. E edhe në këtë pikë pikënisjen e kërkojmë edhe e gjejmë te kumti i Çabejt, sipas të cilit gjatësia historike e zanores fundore të fjalës njërrrokëshe, khs. (geg.) *fē*, (Buzuku, Budi, Bardhi etj. <fee>), është pa dyshim rezultat i ngjizjes së dy zanoreve, që u përftua në shqipe pas bjerrjes së mbylltores dhëmbore të zëshme */-d/, një bjerrje kjo e përftuar në vazhdimësi, gjithsesi sa kohë që në gjuhë ishte, në mos i panjohur, të paktën i vështirë nyjëtimi i saj si i tillë në pozicion ndërzanor (shën. 29). Për rastin tonë, domethënës është gjithashtu rindërtimi i fazave ndërmjetëse që i paraprijnë bjerrjes së kësaj mbylltores të zëshme */-d/ në pozicion ndërzanor në protoshqipe, përkatësisht ngjizjes së mëvonshme (në krasis) të dy zanoreve në strukturën fonologjike të temës së fjalës në /ē/ = (shq. vj.) <ee>, si vijon: (geg. /Buzuku) *fē* < a) (protoshq.) */' fe.e-/ < b) */' fē.de-/ < c) */' fī.de-/ (khs. lat. mesj./ kisht. kall. *fidem*, em. *fides*) < d) lat. (klas.) *fidēs* (kall. *fidēm*) “besë, besim”. Forma e rindërtuar për fazën ndërmjetëse: b) */' fē.de-/ , nuk është se nevojitet doemos, andaj edhe e rindërtojmë *ad hoc* thjesht e vetëm për të motivuar historinë e brendshme të strukturës fonologjike të fjalës në shqipe, khs.: */' fē.de-/ > protoshq. */' fē.e-/ > shq. vj. *fē*. Këtë rindërtim e kërkojmë dhe e hasim si të mirëqenë qysh në fazën (proto)romane të zhvillimit të latinishtes vulgare (të paktën në dhe pas shek. III e.j.), kur – gjatë bjerrjes së tiparit korrelativ të gjatësisë së zanoreve në lat. vulg. – /ī/ (e shkurtër) përjetoj kolizion fonologjik/ fonetik me lat. /ē/ (të gjatë e të mbyllur) duke u ngjizur së bashku në një zanore të mesme të mbyllur */e/, e cila gëzonte atëbotë statusin fonologjik të një foneme të veçantë⁹¹. Prashtu kjo formë ndërmjetëse e rindërtuar */' fē.de-/ nuk do parë patjetër si realitet gjuhësor i përftuar në truall të shqipes, por thjesht dhe vetëm një formë e vonë e latinishtes vulgare, përkatësisht një temë emërore që i takon fazës së hershme romane ballkanike si zhvillim largvajtës të latinishtes (vulgare në periudhën e mesjetës). Për këtë mjafton t'i referohemi këtu faktit se pikërisht këtë formë të rindërtuar (: */' fē.de-/) e përcjellim gjithkund në letërsinë shkencore të romanistikës historike si shembull

⁹¹ Shih Lausberg I 96vv. Në pozicion të patheksuar janë tri fonema të dikurshme që kanë përfunduar në rom. (ballk.) /e/ < lat. /ī/, /ē/ dhe /ē/ (Lausberg 141).

klasik i zhvillimit që përjetoi zanorja e shkurtër dhe e theksuar lat. vulg. /i/ (edhe në rrokje të hapur) në sistemin kualitativ italik të zanoreve (= gjerm. “Italisches Qualitätensystem” – Lausberg *loc. cit.*), ku përfshihet sigurisht edhe romaniteti ballkanik: lat. vulg. /i/ > rom. /e/, khs.: lat. vulg. *fide-* > rom. (ballk.) */fē.de/ > it. *fede*, dalm. *faid* pranë sp. *fe*, katal. *fē*, port. *fē*, fr. *foi* etj. Është bash kjo formë që ka synuar të depërtojë si e tillë pikërisht gjatë kësaj periudhe edhe në fondin leksikor të protoshqipes, duke rrëgjuar aty, siç pritej, edhe mbylltoren e zëshme ndërzanore.

Përsiatjen tonë që kjo fjalë të ketë depërtuar në shqipe gjatë periudhës së mesjetës së hershme jemi në gjendje ta mbështesim tash pa kurrfarë sforcimi me interpretimin fonologjik të procesit të huazimit të disa latinizmave të tjerë në shqipe, të cilët edhe pse përcjellin një strukturë fonologjike të ngjashme, dëshmojnë ndryshime të karakterit strukturor-tipologjik, që nuk mund të përcillen ndryshe, veçse rrjedhojë e kronologjisë së mëhershme të huazimit të tyre në shqipe, bash në një periudhë kur hasim zhvillimin largvajtës të zanores të mesme të përparme: lat. (vulg. – arkifonemë) /E/ (< */ē/ [e] ~ */ē/ [e̞]), që qysh në protoshqipe duket t’i jetë nënshtruar procesit të diftongimit të rregullt në */i/ e/. Bëjmë fjalë në këtë rast për shndërrime fonetike/fonologjike proporcionale në truall të shqipes, të cilat dëshmojnë: a) nga njëra anë depërtimin (pas gjase të hershëm – para shek. II-III e.j.) të lat. *tēgula* > lat. vulg. /'tēgula/ > protoshq. */'tēgula/ > shq. *tjegull*, dial./shq. vj. *tjegullë* (Bardhi 1635 171 23: <tiegulla>), d.m.th. me diftongim në */i/ e/ të zanores së përparme të mbyllur *[e̞] nën theks dhe në rrokje të hapur; dhe b) nga ana tjetër, njëlloj si rastet gjegjëse (pas gjase po aq të hershme) me zanore të shkurtër të hapur: lat. (vulg.) */ē/ [e̞] > protoshq. */i/ e/ > shq. *je*, khs.: lat. *ueterem* > shq. (*i*) *vjetër*. Duke përzier në këtë vorbull shembujsh gjuhësorë edhe një dëshmi të fundit prej fondit latin të shqipes, bash emrin tejet domethënës *mjek*, (shq. vj./geg.) *mjēk* < lat. (klas.) *medicus*, shpresojmë të kemi spikatur tash edhe shëruesin e asaj sëmundjeje kronike-diturake, prej së cilës sa vuajnë aq edhe gëzojnë historianët e gjuhësisë historike-krahasuese: të ashtuquajturës “kronologomani”, që vjen me thënë shqip, tundimi i përhershëm dhe i respektueshëm për të vendosur për çdo rast në veçanti sinorët kohorë në kronologjitë relative dhe absolute për gjithë atë masë dukurish gjuhësore, pa lënë këtu aspak mënjanë edhe proceset e huazimit që përftohen nëpërmjet kontaktit gjuhësor.

Sigurisht që edhe në këtë pikë pikënisjen e kërkojmë dhe e gjejmë në kumtin e Çabejt (SE V 355v), i cili vëren: “Në shqipen e vjetër *mjek* ka qenë shqiptuar me zanore të gjatë (*mjēk*), ashtu si gjer më sot në geg. veriore; është një lloj zgjatimi kompensator, për të vënë në vend, si të thuash, kontraktionin e fjalës latine me zhdukjen e silabës së mesme [...]” Thënë ndryshe, kemi të bëjmë edhe në këtë rast me një gjatësi (historike) kompensatore, të përfutur në protoshqipe pas rënies së mbylltores */-d-/ në pozicion ndërzanor, pra njëlloj si te fjala jonë e shenjtë *fē*. Në vazhdim të analizës sonë diakronike na mjafton tash thjesht dhe vetëm një përfaqje ballafaqe e dy strukturave fonologjike në shqyrtim: *fē* dhe *mjek*, duke marrë për çdo rast në konsideratë edhe shndërrimet fonologjike në rrokjen nistore që përjetuan në shqipe lat. *tēgula* > *tjegull* dhe *ueterem* > (*i*) *vjetër*. Kështu në lidhje me vokalizmin e rrokjes së parë fitojmë proporcionet që vijojnë:

(shq.vj./geg.) *fē* < */'fē.e-/ < lat. vulg. */'fē.de-/ < lat. (mesj./kisht.) *fide-*

(shq. vj./geg.) *mjek* < */'mjē.ek-/ < lat. vulg. */'mę.dek-/ < lat. klas. *medicu-*

(shq.vj.) *tjegullē* < */'tjē.gu.ɫə/ < lat. vulg. */'tę.gu.la/ < lat. klas. *tēgula-*

(shq.vj.) *vjetërē* < */'wjē.tərə/ < lat. vulg. */'wę.tere-/ < lat. klas. *ueter-*

Pranëvënia e këtyre katër shembujve na lejon të kundrojmë rishtas se gjatësia e zanores së theksuar të rrokjes së parë tek emrat (shq. vj./geg.) *fē*, dhe *mjēk* është rezultat i ngjizjes së saj me zanoren ndjekëse, pas bjerrjes së mbylltores dhëmbore të zëshme në pozicion ndërzanor. Këto dukuri, siç pritet, nuk shfaqen tek dy shembujt e fundit (shq. vj.) *tjegullē*, (*i*) *vjetërē*, meqë në shqipe një mbylltore velare e zëshme, sikurse të gjitha mbylltoret e pazëshme janë ruajtur përgjithësisht në atë pozicion (Demiraj 2001 57vv.). Ajo dukuri që bashkon në këtë rast tre shembujt e fundit me njëri-tjetrin është pikërisht diftongimi i zanores së theksuar /E/ në shq. (vj.) /jē/, një diftongim ky që është përfutur gjithkund për zanoren e shkurtër */ē/ në rrokje të theksuar (të hapur) qoftë në fondin e trashëguar të shqipes⁹², ashtu edhe në shtresat e huazimeve të hershme nga greqishtja e vjetër, khs.: *pjepër* < gr. vj. *πέπων*, dhe latinishtja, khs.: lat. *ueterem* > shq. *i vjetër*. Që ky zhvillim ka vijuar edhe pas kolapsit të gjatësisë si tipar fonologjik korrelativ në latinishten vulgare (shek. II-III e.j.) këtë na e dëshmon më së miri shembulli i tretë që morëm në shqyr-

⁹² Për kushtet e tjera fonetike/fonologjike që kanë penguar diftongimin, ose zhvillimin largvajtës të diftongut */jē/ në */ja/ në protoshqipe shih Demiraj 1997 41v.

tim: (shq. vj.) *tjegullë* < */'tj̥e.gu.lə/ < lat. vulg. /'t̥e.gu.la/ < lat. *tēgula*.

Të dhënat e mësipërme lidhur me zhvillimin e natyrshëm të zanores së përparme /E/ > protoshq. */i̯e/, edhe gjatë periudhës së kolapsit të korrelacionit të gjatësisë në sistemin e zanoreve të latinishtes vulgare, fitojnë tash statusin e dëshmitarit okular, sa i përket fiksimit të kronologjisë relative të huazimit të fjalës sonë *fē* në protoshqipe, meqë këtu zanorja e theksuar /E/ në rrokjen e hapur nistore: protoshq. */'f̥e.e-/ < (lat.vulg./rom.) */'f̥e.de-/: lat. mesj./ kisht. *fides* – ndryshe nga tri dëshmitë e tjera me thujtë të njëjtën strukturë fonologjike – nuk i është nënshtruar aspak diftongimit në */i̯e/. Arsyetja e kësaj “kryeneçësije” rezulton të jetë në këtë rast sa e natyrshme aq edhe e thjeshtë: në periudhën e depërtimit të fjalës latine (kishtare/mesjetare) zyrtare *fides*, por popullore (lat. vulg./rom.) */'f̥e.de-/, protoshqipja i kishte mbyllur siparët e vet të diftongimit të zanores */E/ (> /i̯e/) në atë pozicion. Moshën relativisht të vonë të kësaj fjale, që mund dhe duhet të përkojë pikërisht me periudhën e kristianizimit të Ballkanit Perëndimor me orientim nga Kisha Perëndimore (e Romës) dëshmon sigurisht edhe ndonjë njësi tjetër e sferës së besimit të krishterë me thujtë të njëjtën strukturë fonologjike burimore, khs. shq. *meshë* < (vulg. lat./protorom.) */m̥e.sa/ < lat. *missa*.

6. Dy fjalë përmyllëse

Do të ishim sigurisht të paplotë, nëse do t'u anashkalonim në interpretimin tonë gjuhësor diakronik realitet kulturore-historike në motin e huazimit, përkatësisht shndërrimeve që përjetoj në gjuhën shqipe edhe paleta kuptimore e fjalës përgjatë mesjetës, kur lat. mesj. *fides* (= lat. vulg./ rom. */'f̥e.de-/, përpos konsolidimit në përdorimin e saj të specializuar në terminologjinë kishtare si “besimi i krishterë; besimi i fjalës së Zotit”, vazhdon të gjëllijë edhe me kuptime (më) të përgjithshme në diskursin (juridik)-zakonor, si p.sh. “(mirë)besim” e sidomos “dorëzani me fjalëdhënie, premtim i mirëqenë”⁹³, që vjen me thashunë shqip: *fjalë e ndrë/ prerë/ këputur* ~ geg. *fjalë e dame/ preme/ kputme (me dikë për diçka)*. Është pikërisht ky përdorim leksikor që e ndeshim qysh në gurrën latine mesjetare të vetë fjalës, i cili mundi të përballojë motet

⁹³ Khs. *fides publica* “dorëzani për pacënueshmëri/levizje të lirë” (Georges I 2750); shih edhe Habel/ Gröbel 2008³ 152.

në Kanunin e Lekës e që i dha formë e kuptim edhe këtij studimi modest, një studim ky që rreket të dëshmojë vetiu e natyrshëm atë vlerë të pallogaritshme që bartin fshehur në vetvete shumë e shumë njësi të atij fondi leksikor që sendërton në gjuhë matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar. Parë nga kjo perspektivë, vepra fanmirë e Àt Shtjefën Gjeçovit ruan dhe fiton në kohën tonë gjithnjë e më shumë kuptim.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München

FË AND *TË PRËMT E FËS* IN THE KANUN OF LEKË DUKAGJINI

Summary

This study, initially, deals with the issue of the reception of Father Gjeçovi's work at the present time and, first of all, it is taken into consideration The Code of Lekë Dukagjini

The author scrutinizes the semantic spectrum of the word and concept 'religion' in the Albanian lexicography. In this regard, he cites several meanings of this word: 1) "religious belief, religion" as a specific denomination or term in the religious (popular) terminology which is currently widespread in Albanian speaking areas in the Balkans. The use of the term '*fe*' is quite present- especially in the northern part of the Albanian speaking realm- in the daily speech but also in the written language, such as the appellatives used by people: (def.) *besë e besim* like (Turk.) *iman*; on the other hand we have the meaning 2) "one of three holy/theological virtues"; *Religion* against *Hope* and *the Charity* (=it. *fede ~ speranza ~ carità*) as a constituent of, only, Christian terminology appears in those ethnographic areas of (northern) Albania where it is widespread the Christian Catholic-Roman religion. With this meaning is connected the second meaning 3) "manner, behavior", in the areas of northern Albania. Other meanings can be found in the North, too.

The author analyzes the history, internal life or this word in Albanian language from the time and space aspect. He distinguishes two key aspects of meaning: A. "(religious) belief": def. *fë*, (geg) *fë* f. "religious belief (Christian, Catholic/Orthodox or Muslim etc.); a holy virtue; a manner of behavior" ⇒ comp. *fetar*, *i pafë* (~geg; old *i fëshim*, *i pāfë*), adj.: *fetari*, -a f.: *fetarisht* adv.; etc. (FGJSH 2006 267) and B. "The Albanian customary life traditions"; det. * *fë* (dial. north geg) *fë* f. "engagement; the day/engagement celeb.; the girl's wedding" ⇒ *fejtoj* (girl, boy) verb ⇒ *fejesë* f.: i/e *fejuar* adj./m. (FGJSH 2006 265). Lastly, the author points out that in the adaption processes of this medieval Latinism, *fides* (= lat.vulg.rom. */fē.de-/), except the consolidation of its use especially in the Church terminology like "Christian belief; belief in God's word", continues to exist with (more) general meanings in the (legal)-customary discourse, i.e. "(good)faith" and especially "valid pledge, valid promise". According to him, this use survived the time of The Code of Lekë Dukagjini.

Bibliografi**I. Burimet**

- Anonimi i Elbasanit (1761 – dsh.: transliteruar prej Robert Elsie; shih më poshtë)
- Bardhi, Frang (= <R. D. Franciscus Blanchus ~ Frangu i Bardhe>): *Dictionarium Latino-Epiroticum. Una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis. Per R. D. Franciscum Blanchum, Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. Romæ 1635.*
- Budi, Pjetër (= <Peter Budi>): *Dottrina christiana [...] dal Rever. Don Pietro Budi da Pietra Bianca. In Roma 1618.*
- Chetta, Nicolò (= Nikollë Keta): *Leksiko liti kthiellë arbërisht (1763 - dsh.; shih më poshtë Cerniglia 2008).*
- Cordignano, Fulvio: *Dizionario Alb. – Italiano e Ital. – Albanese (Il nuovo “Jungg”). Parte Albanese – Italiana, Roma 1934*
- Dema, Benedikt: *Fjalor fjalësh të rralla në gjuhën shqipe, Tiranë 2005.*
- Figlia, Nicolò: *Il codice chieutino (a cura di Matteo Mandalà). Mezzoiuso 1995.*
- Fjalor i gjuhës shqipe (bot. Xhuvani, Aleksandër – Cipo, Kostaq – Çabej, Eqrem - Myderrizi, Osman), Tiranë 1954 (FGS)
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (bot. Androkli Kostallari), Tiranë 1980. (FGJSSH)
- Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2006. (FGJSH)
- Gazulli, Nikollë: *Fjaluer i Ri. Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë, Tiranë 1941 – (seria: “Visaret e Kombit” bl. XI - VK)*
- Gerbino, Gaetano: *Fjalori i Horës së arbëreshëve. Palermo 2007*
- Giordano, Emanuele: *Dizionario Arbëresh - Italiano. (1963) Castrovillari 2000²*
- Godin, Marie Amelie, Freiin von: *Das albanische Gewohnheitsrecht, in: “Zeitschrift für vergleichende Rechtswissenschaft“ 56 [1953] 1-46, Stuttgart.*
- Gjeçov, Àt Shtjefen O.F.M.: *Kanuni i Lekë Dukagjinit (Vepër postume) përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefen Konst. Gjeçov, O.F.M. Me parathanie t’ A. Gjergj Fishtës, O.F.M. e biografi t’ A. Pashk Bardhit, O.F.M. Shkoder 1933. (bot. III Shkodër 2010)*
- Hoxha, Shefqet: *Kanuni i Lumës, Tiranë 2013.*
- Ilia, Imz. Frano: *Kanuni i Skanderbegut. Mbledhë e kodifikue nga Imzot Frano Ilia Argjipeshkëv Metropolit i Shkodrës. Shkodër 1993. (K. i “Arbënisë”)*
- Jochalas, Titos (= Τίτος Γιοχαλς): *Η αρβανιτιά στο Μοριά, Χρονικά πορείας. Β’ Τομος. Αθήνα 2011*
- Jochalas, Titos (= Τίτος Γιοχαλς): *Ύδρα. Λησμονημένη Γλώσσα. Α. Αθήνα 2006*
- Kavalioti, T. (=Kavalliotis, Theodoros Anastasiu): *Prōtopeiria: To lexikon triglosson [...] (shih më poshtë Hetzer)*
- Kazazi, Gjon N. (= <Joannes Baptista Niccolouich Casasi>): *Breve Compendio della Dottrina Cristiana. Tradotta in lingua Albanese per l’utilità , e istruzione dei Fanciulli di quella Nazione. Da un Nazionale del Regno di Servia Alunno della S. Congregazione. In Roma 1743. 1743*
- Kostë Berati: *Kodiku Beratas (shek XVIII-XIX – dsh.: AQSH Tiranë)*

- Kristoforidhi, Konstandin: Fjalor shqip – greqisht (bot. Aleksandër Xhuvani), Tiranë 1961². (bot. I: Athinë 1903)
- Leotti, Angelo: Dizionario Albanese-Italiano. Roma 1937.
- Matranga, Luca: E mbsuame e kështerë, Roma 1592 (shih më poshtë Mandalà 2004)
- Meçi, Xhemal: Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varanti i Pukës), Tiranë 1997;
- Meçi, Xhemal: Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varanti i Mirditës), Tiranë 2002;
- Martini, Xhafer: Kanuni i Dibrës, Tiranë 2007;
- Schirò, Giuseppe: Opere, vol. VI: *Prose e canti sacri* (shih poshtë Mandalà 1998).

Literaturë shkencore

- Abazi-Egro, Genciana: Sami Frashëri dhe letërsia e bejtexhinjve: një sprovë e parë për botimin e *Divanit* të Nezim Frakullës, SF 1-2 [2005] 119-164)
- Çabej, Eqrem: Studime etimologjike në fushë të shqipes. Bl. IV. Tiranë 1996; Bl. V Tiranë 2014 (SE)
- Cerniglia, Giuseppina (bot.): Chetta, Nicolò: Leksiko liti kthiellë arbërisht (1763 – dsh.; Palermo 2008).
- Demiraj, Bardhyl: Albanische Etymologien, në “Leiden Studies in Indo-European”, Bd. 7, Amsterdam – Atlanta GA 1997.
- Demiraj, Bardhyl: Ligji i Meyer-it mbi bjerren e mediave ndërzanore në gjuhën shqipe (rivlerësim), në: “Studime” 5-6-7 [1998/1999/2000] 257-293, Prishtinë.
- Demiraj, Bardhyl: Das Meyersche Gesetz über den Schwund der intervokalischen Media im Albanischen, në: “Münchener Studien zur Sprachwissenschaft“ 61 [2001] 57-93, Dettelbach.
- Demiraj, Bardhyl: Sulla perdita delle occlusive sonore intervocaliche nello strato latino del lessico albanese, në: “Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia – Atti del XXVIII Congresso Internazionale di studi Albanesi – 16-19 maggio 2002 (a cura di Matteo Mandalà). Palermo 2003 171-181.
- Demiraj, Bardhyl: Einheitlichkeit und Spaltung im Laufe des Christianisierungsprozesses der Albaner. Eine ethnolinguistische Fallstudie, në: “Studime” 8-9 [2001/2] 23-41. Prishtinë.
- Demiraj, Bardhyl: Rrënjë dhe degë të krishterimit ndër shqiptarë, në: “Hylli i Dritës” 2 [2011] 58-78, Shkodër.
- Demiraj, Shaban: Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë 2013²
- Dodaj, P. Paolo (përkth./bot.): P. Stefano Cost. Gjeçov: Codice di Lek Dukagjini ossia Diritto consuetudinario delle montagne d’Albania. Roma 1941.
- Elezi, Ismet: E drejta zakonore e Labërisë në planin krahasues, Tiranë 1994.
- Elsie, Robert (bot.) “The Elbasan Gospel Manuscript (“Anonimi i Elbasanit”, 1761, and the struggle for an Original Albanian Alphabet, në: “Südost-Forschungen” 54 [1995] Jök1105-159.
- Fox, Leonard (përkth./bot.): Kanuni i Lekë Dukagjinit – The Code of Lekë Dukagjini. Forest Hills, NY 1989.

- Gut, Christian: Le Kanun de Lekë Dukagjini (Texte imprime), Pejë 2001.
- Habel, E / Gröbel, F.: Mittellateinisches Glossar. Paderborn - Stuttgart 2008³
- Helbig, Robert: Die italienischen Elemente im Albanesischen. Leipzig 1903.
- Hetzer, Armin (bot.): Kavalliotis, Theodoros Anastasiu: das dreisprachige Wörterverzeichnis von Kavalliotis, Theodoros Anastasiu Kavalliotis, në serinë: "Balkan-Archiv" Neue Folge - Beiheft Bd. 1 Hamburg 1981
- Lausberg, Heinrich: Romanische Sprachwissenschaft I. Einleitung und Vokalismus, në: "Sammlung Göschen" Bd. 128/128a Berlin 1956.
- Mandalà, Matteo (bot.): Giuseppe Schirò: Opere, vol. VI: *Prose e canti sacri*. Rubbettino 1998
- Mandalà, Matteo (bot.) : Luca Matranga: E mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà). Caltanissetta 2004
- Martucci, Donato (bot.): Il Kanun di Lek Dukagjini. Le basi morali e giuridiche della società albanese. Nardo (LE) 2013.
- Meyer-Lübke, Wilhelm: Romanisches Etymologisches Wörterbuch, Heidelberg 1935. (REW)
- Miklosich, Franz: Albanische Forschungen II. Die romanischen Elemente im Albanischen, in: Sitzungsberichte d. Kais. Akad. d. Wiss. in Wien, Bd. 20. Wien 1870, 1-80. (AF II 26)
- Orel, Vladimir: Albanian Etymological Dictionary. Leiden - Boston - Köln 1998.
- Xhuvani, Aleksandër (bot.): shih më lart (burimet) Kristoforidhi, K.